



BURSA PËR KURSIN VEROR TË GJUHËS ÇEKE

Në kuadër të Programit “*Summer Schools of Slavonic Studies 2019*”, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Çekisë ofron 2 (dy) bursa për pjesëmarrje në kurset verore të gjuhës çeke për studentët dhe mësuesit shqiptarë që kanë njohuri ose studiojnë gjuhën çeke. Kurset do të mbahen për një periudhë intensive 4-javore në 3 nivele (fillestar, i mesëm dhe i avancuar) pranë Universitetit të Karlit (Charles University) në Pragë në datat 26 korrik – 23 gusht 2019: web (<http://lsss.ff.cuni.cz/en/>); email (lsss.praha@ff.cuni.cz) dhe pranë Universitetit Masaryk në Brno në datat 20 korrik – 17 gusht 2019: web (<http://www.phil.muni.cz/kabcest/en/summer-school.php>); email: (eva@phil.muni.cz).

Kandidatët e interesuar për kurset e mësipërme duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda datës **11 shkurt 2019**, dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

1. Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës çeke të firmosur (ku te vendoset adresa dhe kontaktet);
2. Formularin e aplikimit, të cilin mund ta shkarkoni në faqen web: <http://www.msmt.cz/file/49220/>;
3. Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit I dhe II të studimeve të larta ose pasuniversitare;
4. Kopjen e noterizuar të listës së notave;
5. Vërtetimin nga universiteti përkatës për kandidatët që ndjekin aktualisht studimet universitare/pasuniversitare;
6. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
7. 2 (dy) fotografi;

Për kurset e mësipërme preferohen kandidatët që kanë njohuri bazë të gjuhës Çeke. Kandidatët e interesuar duhen të jenë mbi moshën 18 vjeç.

Pala çeke përballon shpenzimet për ushqimin, regjistrimin, programin mësimor dhe kulturor, akomodimin, transportin publik brenda qytetit dhe ekskursionet, ndërsa shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje dhe ato të siguracionit shëndetësor do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e kursit.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni adresës në web-site:

<http://www.msmt.cz/eu-and-international-affairs/summer-schools-of-slavonic-studies;>

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhet formulari i aplikimit.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS